Shtojca 2: Formulari i Ofertës Ekonomike në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafiku i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) ~~Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.~~

b) ~~Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.~~

e) ~~Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.~~

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) — Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) ~~çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;~~
- b) ~~elementet fiskale;~~
- c) ~~normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;~~

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Art ikul li	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.	Qeska mbeturinash 240 litroshe	80 pako			
2.	Qeska mbeturinash 100 litroshe	70 pako			
3.	Qeska mbeturinash 35 litroshe	200 pako			
4.	Letër higjenike e paketuar (min 6 rulon/paketim)	750 pako			
5.	Acid për pastrim	50 litër			
6.	Solucion larës dyshemeje (pllakash)	700 liter			
7.	Hipoklorit Natriumi NaOCl 10-12%	800 litër			

8.	Sfungjer enësh i thjeshtë (11cmx7.5cmx3.3cm)	200 copë			
9.	Peceta pluhrash të thjeshta (3 fije/pako)	100 pako			
10.	Doreza Latex ose Nitrile	70 pako			
11.	Shtupë për larje dysHEMEJE	100 copë			
12.	Bishta fshese/shtupe	50 copë			
13.	Fshesë për pastrim territori, melakuqi	50 copë			
14.	Sapun i lëngshëm	200 litër			
15.	Kovë plastike me shtrydhje	15 copë			
16.	Solucion për zhbllokim lavamani	20 litër			
17.	Solucion për pastrimin e smërçit/kriprave nga hidrosanitaret me mekanizëm sprucimi	20 litër			
18.	Aromatik tualeti	30 copë (750 ml)			
19.	Letër guzhine e paketuar 2 kg	180 rolo			
20.	Solucion larës për mobilje	20 copë (750 ml)			
21.	Solucion larës enësh lëng	50 litër			
22.	Solucion për heqjen e yndyrnave nga betoni	100 kg			
23.	Aparat për aromatizues ambientit me kohë sprucimi (për aromatizues 250 ml)	4 copë			
24.	Aromatizues ambientit për aparatit	20 copë (250 ml)			

25.	Letra të lagura higjienike për të rritur (min 100 fije/pako)	50 pako			
26.	Krem antibakterial:	20 copë			
27.	Gota plastike (50 copë/pako)	30 pako			
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 4.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]*

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

NR	ARTIKUJT	NJËSIA	SPECIFIKIMET TEKNIKE
1	Qeska mbeturinash 240 litorshe	pako	Të jenë rezistente, të kenë kapacitet mbajtës 240 litër , të jenë të forta, materiali plastik. 30 copë pako ose 3*10 copë për pako

2	Qeska mbeturinash 100 litroshe	pako	Të jenë rezistente, të kenë kapacitet mbajtës 100 litër , materiali plastik I fortë. 30 copë pako ose 3*10 copë për pako
3	Qeska mbeturinash 35 litroshe	pako	Të jenë rezistente, të kenë kapacitet mbajtës min 35 litër dhe të përmbajë min 30 copë ose 3*10 copë për pako, të jenë të forta, materiali plastmasi. Të jetë produkt i biodegradueshëm.
4	Letër higjienike e paketuar (min 6 rulon/paketim)	pako	Të jetë me paketim min 6 rulon/pako, fletëpalojse zig-zag në pako me fije dhe me shkëputje. Të jetë cilësore dhe e butë. Të jetë e tretshme në ujë. Peshe një ruloni mbi 500 gr.
5	Acid për pastrim	litër	Të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Zbardhës alkaline me aftësi vepruese dezinfektante. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbajë në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0-3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm ³ . Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
6	Solucion larës dyshemeje (pllakash)	litër	Me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH të jetë 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjene. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm ³ -1.1 gr/cm ³ . Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. I përshtatshëm për vende higjienike, dhoma zhveshje, palestra dhe kudo ku ka probleme arome të pakëndshme. Ambalazhimi të jetë në bidona nga 1 deri në 5 litra, i biodegradueshëm. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
7	Hipoklorit Natriumi NaOCl 10-12%	litër	Ku përmbajtja e klorit aktiv të jetë 10-12%. Përmbajtja e alkalitetit jo më shumë se 5%, të mos ketë përmbajtje të lëndëve të ngurta, të ketë ngjyrë të verdhë deri në kafe të çelët, me erën karakteristike shpues në hundë. Ambalazhimi të jetë me bidona plastik të përshtatshëm që ti rezistojnë efektit shpues të “klorit”. Ambalazhimi të jetë i etiketuar ku të paraqitet titulli i klorit aktiv. Të jetë cilësor
8	Sfungjer enësh i thjeshtë (11cmx7.5cmx3.3cm)	copë	Të jenë të përdorshëm për pastrim pjatash, tenxheresh dhe kazanësh. Të jenë me pore të

			vogla në përbërjen e sfungjerit dhe me rrjete teli të butë për pastrim sipërfaqesh të ashpra.
9	Peceta pluhrash të thjeshta (3 fije/pako)	pako	Të jenë të paketuara në qese min 3 fije/pako. Të jenë me shumë se një përdorimëshe. Të kenë veti të mira përthithëse
10	Doreza Latex ose Nitrile	pako	Josterile, me ose pa pudër, njëpërdorimshe, në masat XS, S, M, L, XL (sipas kërkesës së punonjësve), të jenë të paketuara në pako kartoni ose plastike, me minimumi 100 copë/pako. Të ketë certifikimin CE ose FDA ose ekuivalent. Afati i skadencës të jetë të jetë të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes.
11	Shtupë për larje dyshemeje	copë	Përbërë nga fibra tekstili me përbërje pambuku që thithin ujin shumë mirë. Dendësia e shtupës të jetë jo më e vogël se 250 gr. T'i bashkëngjitet shtupës, shkopi me veshje plastike me gjatësi normale, jo më të shkurtër se 100 cm, të Faqe 18 nga 27 jetë me efekt vidhimi. Materiali i shkopit të jetë alumini nga brenda dhe plastik nga jashtë.
12	Bishta fshese/shtupe	copë	Shkop për fshesa/shtupa Përmasat: 100-180 cm. Materiali inoks. Filetoja te pershtatet per shtupen e pastrimit
13	Fshesë për pastrim territori, melakuqi	copë	Fshesa të jetë me fije të dendura, të buta plastike, me gjatësi mbi 10 cm. Të jetë për pastrim të ambienteve të brendshme. Të jenë rezistente gjatë forcës së fshirjes së sipërfaqes. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme me mekanizmin e rrotullimit nga e djathta në montim me shkopin. Vendi i vendosjes së shkopit të jetë standard. Pesha e saj të jetë jo më e vogël se 340 gr.
14	Sapun i lëngshëm	litër	Ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1 gr/cm ³ . Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5.0 deri në 11%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe

			barkodin e prodhimit të fabrikës.
15	Kovë plastike me shtrydhje	copë	Të jetë plastike, e thellë dhe të kenë një dorezë mbajtëse nga sipër për transportimin e kovës, kova të jetë së bashku me kapakun e shtrydhjes së shtupës. Kapaciteti mbajtës të jetë me volum min 10 Litër
16	Solucion për zhbllokim lavamani	litër	Me efekt zhbllokimi të shpejtë, të mos krijojë shkumë dhe të mos dëmtojë tubat plastike. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni trajtë pluhuri sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
17	Solucion për pastrimin e smërçit/kriprave nga hidrosanitaret me mekanizëm sprucimi	litër	Ambalazhimi në shishe plastike për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, të pastrojë në thellësi kripërat e ujit nga hidrosanitaret. Të parandalojë krijimin e kripërave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
18	Aromatik tualeti	Copë (750 ml)	Me efekt pastrimi dhe dezinfektimi. Të jetë aromatizues i lëngshëm.
19	Letër guzhine e paketuar 2 kg	rolo	Letra të jetë e paketuar, standard me rula. Të jetë cilësore. Të jetë mbi 60m dhe të jetë me shkëputje. Ngjyrë e bardhë, materiali 100 % celulozë, me paketim jo më pak se 400 prerej , të jetë cilesor edhe i padëmshëm për shëndetin e njeriut. Pesha e rulonit min 2 kg.
20	Solucion larës për mobilje	Copë (750 ml)	Me efekt pastrimi të njollave të forta dhe pluhurave tek mobiljet. Pastrues neutral me pak shkumë. Ambalazhimi në shishe plastike dhe me kokë shisheje me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë parfumi. Të jetë i tretshëm 100% në ujë. Densiteti të jetë nga 0.9 gr/cm ³ deri në 1.2 gr/cm ³ . Vlera e PH të jetë nga 6 deri në 7.5. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 7%.

21	Solucion larës enësh lëng	litër	Me efekt pastrimi të thellë. Ambalazhimi në shishe plastike dhe të ketë analizën spektrale në etiketë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen dhe viskoze, të ketë aromë parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Vlera e PH 6 deri në 10. Faqe 13 nga 27 Densiteti të variojë nga 0.9 gr/cm ³ deri në 1.2 gr/cm ³ . Lënda tensioaktive të jetë nga 15% deri në 20%.
22	Solucion për heqjen e yndyrnave nga betoni	kg	Solucion për heqjen e yndyrnave nga sipërfaqet e betonit
23	Aparat për aromatizues ambienti me kohë sprucimi (për aromatizues 250 ml)	cope	Aparat për aromatizues: Aparat për ambient me kohë sprucimi me kapacitet për mbajtjen e solucionit. Të jetë i pajisur me bateri përkatëse.
24	Aromatizues ambienti për aparatin	copë (250 ml)	Të jetë statik për tu vendosur në mur në mënyrë të pavarur. Të jetë me aromë të këndshme
25	Letra të lagura higjienike për të rritur (min 100 fije/pako)	Pako	Letra të lagura higjienike: me aromë natyrale, e përdorshme për higjienën min 100 fije/pako, për të rritur. Të jetë e testuar dermatologjikisht, ti përshtatet pH të lëkurës. Letra të lagura higjienike për të rritur (min 100 fije/pako).
26	Krem antibakterial:	copë	Antiseptik me veti dezinfektuese. Eleminon deri në 99.99% të bakteve. Nuk e than lëkurën
27	Gota plastike (50 copë/pako)	Pako	Të jenë cilësore. Paketimi në qese plastike jo më pak se 50 copë/ pako, jo më shumë se 200 ml madhësia e nxënies së gotës. Të jenë të biodegradueshme dhe një përdorimëshe.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Transporti do të sigurohet nga vetë furnizuesi deri në Portin Detar Sarandë.

- Në rast se malli nuk plotëson kërkesat, nuk do të merret në dorëzim.
- Kontrolli lidhur me sasinë, cilësinë dhe elementët e tjerë teknik do të bëhet nga një komisioni i veçantë i ngritur nga titullari i Autoritetit Kontraktor, përpara procedurës së marrjes në dorëzim të mallit.
- Në qoftë se mallrat pas verifikimit nuk plotësojnë kërkesat e pasqyruara në zë dhe në të dhëna teknike blerësit i kthehen mbrapsht, nuk kryhet likuidimi i faturës deri në zëvendësimin e plotë të materialit të kërkuar. Kostoja për këto lëvizje do të mbulohet nga blerësi.
- Për detaje me të veçanta do të përcaktohen në kontratën objekt prokurimi me operatorin ekonomik të shpallur fitues.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
Materiale pastrami, detergjentë.	Sipas specifikimeve teknike (Shtojca 6)	Sipas listës të artikujve - Shtojca 3	Porti Detar Sarandë	7 (shtatë) ditë

Afati i levrimit të mallit do të jetë 7 (shtatë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

c. *Formulari i ofertës sipas Shtojcës 1 dhe Shtojcës 3*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

- a) Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.
- b) Të jetë i specifikuar në QKB objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik i njëjtë ose ekuivalent me objektin e prokurimit.
Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës.

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2025 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar).

Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur vërtetim nga të gjitha organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin.

Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2. Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3. Operatori ekonomik ditën e zhvillimit të tenderit duhet të paraqesë fizikisht mostrat për artikujt e tabelës së mëposhtme, të shoqëruara me Skedat teknike. (nga një moster për secilin artikull).

Skedat duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe nëse janë në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer e të noterizuara. Në skedat teknike duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave (specifikimeve teknike) të kërkuara me produktet e ofruara.

Operatori ekonomik ditën e zhvillimit të tenderit duhet të paraqesë fizikisht mostrat për artikujt e tabelës së mëposhtme:

Nr. sipas Preventivit	Emërtimi
1	Qeska mbeturinash 240 litorshe
4	Letër higjenike e paketuar (min 6 rulon/paketim)
6	Solucion larës dysHEMEJE (pLLAKASH)
7	Hipoklorit Natriumi NaOCl 10-12%
14	Sapun i lëNGSHËM
19	Letër guzhine e paketuar 2kg

- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambientet e protokollit të AK.
- Çdo moster e paraqitur pas orarit të përcaktuar për hapjen e procedurës nuk do të pranohet.
- Mostrat e kërkuara duhet detyrimisht të jenë të vulosura me vulën e ofertuesit, emrin e ofertuesit, datën e zhvillimit të tenderit, të nënshkruara në vende të dallueshme dhe të ketë numrin rendor korespondues me emrin e artikullit.
- Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse. Nëse mostrat nuk janë sipas specifikimeve OE do të skualifikohet.
- **Mosparaqitja e mostrave, skedave teknike ditën e zhvillimit të tenderit është kusht për skualifikimin e operatoreve.**

2.3.4. Subjekti ofertues duhet të paraqesë deklaratën si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se nëse shpallet fitues, mallrat do të jenë të njëjtë me mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë për skadencën e mallrave, e cila duhet të jetë jo më pak se 1 (një) vit nga momenti i lëvrimin të mallit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë, se merr përsipër të kryej vetë shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi pranë ambienteve të ambienteve të Portit Detar Sarandë.

Mosdeklarimi si më sipër, përbën kusht për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

•
nformacion mbi subjektet

mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

⁶ Për qëllim të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2

të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

